



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Punëto/Prodato Received/Delivered		18-04-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojcë Prilog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK	3667/2023		1/6	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.365/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.365/2023 të datës 16.02.2023, të parashtruar nga ankuesja _____, kundër Vendimit me numër protokollit 02-016-13278 të datës 03.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 18.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.365/2023 e datës 16.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. *Shfuqizohet* Vendimi me numër protokollit 02-016-13278 i datës 03.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit.
- III. *Obligohet* Kryetari i Komunës së Gjilanit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagës për ankuesen, e ndaluar sipas Vendimit të shfuqizuar si në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile _____ e punësuar në Komunën e Gjilanit më datë 16.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 02-016-13278 të datës 03.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, me pretendimet për shkelje të ligjit materiale dhe dispozitive procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunen e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit më datë 02.03.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 3145/2023 të datës 29.03.2023 ka bërë shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1849/2023 të datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 07.12.2022 të Zyrës Kadastrale të Komunës së Gjilanit; Aktvendimin e datës 12.10.2022 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Gjilanit; Njoftimin lidhur me prezantimin e dokumentacionit të datës 07.11.2022; Plotësimin e ankesës e datës 20.02.2022; Vendimin me numër protokollit 02-016-130466 të datës 08.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit; Emailin e datës 15.09.2022 nga B.S për B.Sh; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 08.08.2022, 10.11.2022, 20.07.2022 nga E.Sh; Dëftesën e datës 08.08.2022 me Nr. serik 204219; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 2115/2022 e datës 24.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2244/2023 e datës 02.03.2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me numër protokollit 02-1079 e datës 11.10.2022; Ftesën për shqyrtim kryesor e datës 27.01.2023 për ankesën, për iniciuesin e procedurës disiplinore; Vendimin me numër protokollit 02 Nr. 484 i datës 31.05.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 31.01.2023; Emailin e datës 23.12.2020 nga K.A; Emailin e datës 05.08.2022 nga N.Sh për ankuesen; Emailin e datës 04.08.2022 nga ankuesja; Emailin e datës 15.09.2022 nga B.Sh për A.A; Emailin e datës 07.10.2022 nga E.X për B.S; Emailin e datës 07.10.2022 nga B.S për A.A; Emailin e datës 07.10.2022 nga B.S për E.X; Certifikatën e lëshuar nga Njësia Kadastrale në Gjilan; Kërkesën drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë në Gjilan nga E.Sh; Vendimin e datës 20.07.2022 nga Drejtori e Bujqësisë dhe Pylltarisë së Komunës së Gjilani; Kopja e Planit; Vendimin me Nr. 07-350/02-0046206/22 i datës 03.06.2022 për caktimin e kushteve ndërtimore nga Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit; Ankesën me numër protokollit 7338/2022 të datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës më datë 07.12.2022 me numër protokollit 7725/2022; Aktvendimin me numër reference: 10-942-91363-2022 i Zyrës Kadastrale të Komunës së Gjilanit; Vendimin me numër 01 Nr.016-59966 i datës 26.05.2022 i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit; Aktvendimin me numër reference: 10-942-131504-2022 i datës 07.12.2022 për pezullimin e përkohshëm të procedurës; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 20.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 7517/2022 e datës 01.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 8000/2022 e datës 13.12.2022; Akt Emërimit me numër protokollit 01-16-19967 i datës 22.07.2011 për ankuesen; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 28.01.2022; Vendimin me numër protokollit 02-111 i datës 20.02.2020 për pushim të lehonisë për ankuesen; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 04.11.2022; Njoftimin me numër protokollit 02-016-120645 të datës 12.10.2022; Ftesën për shqyrtim kryesor me numër protokollit 02-016-122476

e datës 18.10.2022; Vendimin A.nr.1046/2022 i datës 30.12.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër protokolli 3145/2023 të datës 29.03.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale Kolegji i Këshillit ka gjetur së ankuesja në bazë të Akt Emërimit me numër protokolli 02-16-19967 të datës 22.07.2011 ka statusin e nëpunëses civile dhe së e njëjta ushtron pozitën *Inxhinierë e Gjeodezisë* në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në Komunën e Gjilanit.

Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjilanit më datë 11.10.2022 ka parashtruar kërkesë në Komisionin Disiplinor për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses me arsyetimin së e njëjta ka bërë shkelje të rënda disiplinore në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ankuesja ka refuzuar të aprovoj kërkesën e palës dhe për ndërrim të destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit me Vendimin me numër protokolli 02-016-130466 më datë 08.11.2022 ka shpallur përgjegjëse ankuesen për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik lidhur me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore *"ndalim i 20% të pagës mujore për periudhën një (1) mujore"*.

Ankuesja kundër vendimit të Komisionit Disiplinor brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1046/2022 të datës 30.12.2022 ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 02-016-130466 të datës 08.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, dhe ka detyruar organin që ka nxjerr vendimin e anuluar që të rishqyrtoj ketë çështje. Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit në ri procedurë serish me Vendimin me numër protokolli 02-016-13278 të datës 03.02.2023 ka shpallur përgjegjës ankuesen për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, lidhur me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore *"ndalim i 20% të pagës mujore për periudhën një (1) mujore"*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 02-016-13278 të datës 03.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, pretendon se refuzimi i kërkesës me numër protokolli 10-942-91365-2022 të datës 20.07.2022 lidhur me ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është bërë për faktin së ndryshimi i kulturës nga arë në tokë ndërtimore behët vetëm më vendim të organit kompetent të urbanizmit e jo vendimi të Drejtorisë së Bujqërisë ndërsa vendimi i Drejtorisë së Bujqësisë shërben vetëm për ndryshim të destinimit, sepse ndryshimi i destinimit behët me plane urbanistike respektivisht Planin Zhvillimor Komunal, rrjedhimisht pronari duhej të bënte parcelimin e pronës në fjalë e pastaj të lëshohet ne kushte ndërtimore dhe leja e ndërtimit dhe së kërkesa për destinim duhet të behej tek gjeodeti apo kompania gjeodete.

Bazuar në kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, theksohet se më datë 08.08.2022 është pranuar lënda e palës dhe e cila i është ndarë ankueses, e cila ka refuzuar lëndën ndërsa pas analizimit të lëndës me zyrtarët ligjore dhe zyrtarët e gjeodezisë kemi ardhur në përfundim që lënda duhet të aprovohet, ndërsa zyrtarja prapë ka refuzuar të aprovojë këtë lëndë.

Në kuptim të vendosjes meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: *"shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë nuundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë"*.

Nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*.

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: *"1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor"*.

Bazuar ne kuadrin ligjor si me lartë, Kolegji ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankueses, sepse, nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet fakti së ankuesja kishte refuzuar kryerjen e detyrave të punës, mirëpo e njëjta nuk kishte regjistruar në sistem kërkesën e palës dhe për ndryshimin e destinimit të parcelës me numër 1432-29 ZK Gjilan, me pretendimin së regjistrimi i kërkesës në fjalë është në kundërshtim më dispozitat ligjore, andaj mbi këtë bazë e në kuptim të nenit 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji vlerëson së zyrtari publikë në rast së *dyshon për paligjshmërinë e*

urdhrit të mbikëqyrësit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë mbikëqyrësin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e mbikëqyrësit.

Rrjedhimisht, nga vlerësimi i provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni Disiplinor në vendimin e goditur me ankesë ka dhënë vetëm konstatime të përgjithshme, pa specifikuar se cilat kanë qenë faktet relevante për vendimmarrje përkatësisht Vendimi me numër protokolli 02-016-13278 i datës 03.02.2023 mbështet vetëm në citate të deklaratave të personave të dëgjuar gjatë procedurës disiplinore, pa konstatim të bazës ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret, kështu që në këtë kuptim dhe duke u bazuar në nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Ndërlidhur si me lartë, e në aspekt të vendosjes meritore Kolegji po ashtu nga analizim i provave të lëndës ka gjetur së Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar nuk kishte marrë parasysh faktin se mbikëqyrësi i ankueses edhe përkundër kërkesës së ankueses nuk kishte dhënë asnjë udhëzim gojorë pse duhet të ekzekutohej kërkesa e datës 08.08.2022 nga ana e ankueses, apo që i njëjti të ketë ofruar sqarime nga njësi kompetente ligjore e organit të punësimit, përkundër që është pretenduar në shkresën për inicim të procedurës disiplinore së ka pas konsultime me zyrtaret ligjor, por që një fakt i tillë nuk provohet me asnjë dëshmi materiale. Në këtë kontekst, Kolegji thekson faktin së Komisioni Disiplinor po ashtu nuk e kishte marr për bazë sqarimin e datës 07.10.2022 të Agjencisë Kadastrale ku në përmbajtje të së cilës është theksuar se: *“Në bazë të dokumentacionit shihet që ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është bërë vetëm për pjesën ku shtrihet objekti (P+0) me sipërfaqe 127 m², lidhur me këtë pala duhet të sqarohet me Drejtorinë e Urbanizimit pasi që në vendimin e kushteve ndërtimore në pikën III ceket që pagesa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të behët për parcelën 1432-29 ZK Gjilan duke mos specifikuar sipërfaqen 127 m² por vetëm parcelën. Nëse Vendimi i datës 20.07.2022 për ndërrimin e destinimit të tokës është në pajtim me kushtet ndërtimore, atëherë mund të regjistrohet në SIKTIK pa pas nevojë për ndonjë dokument tjetër nga ky që është dorëzuar”*.

Theksuar si me sipër, dhe duke qenë së Vendimi me numër protokolli 02-016-13278 i datës 03.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, është përfshirë më shkelje të dispozitave ligjore, Kolegji konstaton së një akt administrativ i nxjerr si rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative dhe në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që mbi këtë bazë rezulton së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses.


Nisur nga te gjeturat dhe konstatimet si me lart, Kolegji në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë*

(30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.365/2022

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;